RAPORT INDIVIDUAL I KONSULTIMIT PUBLIK

1. Titulli i projekt aktit

Projektligji “Për kinematografinë dhe audiovizualin”

Projektligji “Për kinematografinë dhe audiovizualin” përbën një transformim substancial dhe gjithëpërfshirës të arkitekturës normative që rregullon industrinë filmike dhe krijimtarinë audio vizuale në Republikën e Shqipërisë. Në një kontekst global ku dinamika teknologjike, ekonomike dhe kulturore ka rimodeluar në mënyrë të vazhdueshme mënyrat e prodhimit, financimit dhe shpërndarjes së përmbajtjeve, nevoja për një kuadër ligjor modern dhe funksional shfaqet si një kërkesë e domosdoshme strategjike, kjo pasi ligji aktual nr. 8096, datë 21.3.1996 “Për kinematografinë”, i miratuar në vitin 1996 dhe i ndryshuar pjesërisht në vitin 2005, është konceptuar në një kontekst krejtësisht të ndryshëm. Ky ligj, ndonëse ka shërbyer si bazë për zhvillimin e kinematografisë shqiptare në periudhën pas tranzicionit, nuk parashikon instrumente të përshtatshme për të adresuar zhvillimet e reja në fushën e prodhimit audio vizual, sidomos në raport me platformat digjitale, bashkëprodhimet ndërkombëtare dhe mekanizmat bashkëkohorë të financimit.

Në këtë kuadër, projektligji i ri synon të krijojë një bazë ligjore moderne dhe funksionale, e cila jo vetëm rregullon veprimtarinë ekzistuese, por edhe orienton zhvillimin e ardhshëm të sektorit në përputhje me standardet europiane dhe praktikat ndërkombëtare më të mira. Projektligji propozon një qasje të re konceptuale dhe institucionale, duke kaluar nga një model tradicional mbështetjeje për prodhimin filmik drejt një vizioni të integruar që përfshin të gjithë spektrin e krijimtarisë audio vizuale, përfshirë format televizive, prodhimet për platformat digjitale, veprat eksperimentale, videolojërat dhe formatet hibride,, duke forcuar mekanizmat e qeverisjes së mirë dhe orientim të sektorit drejt standardeve europiane të rregullimit, transparencës dhe konkurrueshmërisë.

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Specifikoni kohëzgjatjen e përgjithshme të konsultimeve publike sa i përket ditëve të punës, përfshirë datën e hapjes dhe mbylljes së konsultimeve publike; nëse kohëzgjatja ishte më e shkurtër se 20 ditë pune e paraparë me ligj, jepni arsye për shkurtimin e kohëzgjatjes.

Procesi i konsultimit publik nëpërmjet RENJKP ka zgjatur nga data 12.05.2026 deri në 9.6.2026, njëzetë (20) ditë të plota pune, proces gjatë të cilit nuk pati komente apo sugjerime lidhur me projektligjin. Gjithashtu është kryer edhe

konsultimi përmes komunikimit elektronik, gjithashtu ka komente dhe sugjerime, prej tyre.
Procesi i konsultimit publik për projektligjin "Për kinematografinë dhe audiovizualin" është zhvilluar përmes Regjistrit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike (RENJKP), si dhe nëpërmjet komunikimit elektronik dhe konsultimeve me grupet e interesit. Megjithëse afati minimal i konsultimit publik i parashikuar nga ligji nr. 146/2014 është 20 ditë pune, Ministria vijoi të pranojë komente dhe sugjerime edhe pas përfundimit të këtij afati, me qëllim sigurimin e një procesi sa më gjithëpërfshirës dhe marrjen në konsideratë të kontributeve të aktorëve të sektorit. Në total, procesi i konsultimit dhe i pranimit të komenteve ka vijuar për afërsisht dy muaj (deri n datë 24.07.2026).

3. Metoda e konsultimit

Listoni të gjitha metodat e konsultimit të përdorura, të tilla si konsultimet elektronike (Regjistri Elektronik, posta elektronike, faqet e internetit, etj.), Takimet publike, seancat e organeve këshilluese…, dhe siguroni informacione për afatin kohor, kohëzgjatjen dhe afatet e tyre. Shpjegoni se si u shpërnda informacioni mbi konsultimet e hapura, si u ftuan palët e interesuara të kontribuojnë. Përfshini gjithashtu aktivitete nga konsultimet paraprake nëse janë organizuar të tilla).

Metodat e konsultimit të përdorura për projektligjin "Për kinematografinë dhe audiovizualin", ishin:

1. Konsultimi elektronik përmes Regjistrit Elektronik, RENJK (12.5.2026 - 9.6.2026);

Në RENJKP janë regjistruar 1071 shikime.

2. Konsultimi nëpërmjet komunikimit elektronik (posta elektronike) me institucionet, organizatat profesionale, subjektet e industrisë kinematografike dhe audiovizuale, si dhe grupet e tjera të interesit;

3. Takime dhe diskutime teknike me përfaqësues të sektorit kinematografik dhe audiovizual.

Lidhur me takimet e mbajtura, informojmw se gjatë procesit tw konsultimit publik janë zhvilluar gjithsej 14 takime, përkatësisht në datat: 6.1.2026, 9.1.2026, 13.01.2026, 16.1.2026, 19.1.2026, 21.1.2026, 26.1.2026, 2.4.2026, 7.4.2026, 14.4.2026, 164.2026, 23.04.2026, një takim online në fillim të muajit korrik 2026, si dhe takimi i datës 9.7.2026.

Informacioni mbi konsultimin publik është bërë i aksesueshëm nëpërmjet publikimit të projektligjit në RENJKP. Gjithashtu, komunikimi elektronik, takimet dhe konsultimet me palët e interesuara kanë mundësuar përfshirjen aktive të përfaqësuesve të sektorit kinematografik dhe audiovizual, paraqitjen e mendimeve dhe sugjerimeve të tyre, si dhe diskutimin dhe shqyrtimin e propozimeve në funksion të përmirësimit të përmbajtjes së projektligjit.

4. Palët e interesit të përfshira

Listoni të gjithë palët e interesuara, qoftë organizata apo individë, të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike përmes metodave të ndryshme të konsultimit, gjatë gjithë procesit të hartimit.
Përmendni gjithashtu numrin dhe strukturën e palëve të interesuara që morën pjesë në takime publike ose seanca të organeve këshilluese.
Specifikoni palët e interesuara që morën pjesë në grupin e punës për hartimin e aktit.

Në procesin e konsultimit morën pjesë organizata profesionale të sektorit të kinematografisë dhe audiovizualit, subjekte të tregut audiovizual, organizata të menaxhimit kolektiv të të drejtave të autorit, institucione publike, profesionistë të fushës dhe individë të interesuar.

Ndër palët kryesore që paraqitën komente dhe sugjerime përfshihen: AWA, APFA, Shoqata Lumiere, TV KLAN, TRING TV, ASC, KOELF, Motion Picture Association (MPA), DDA, AQSHF, si edhe individë të industrisë kinematografike si Florenc Papas, Bujar Alimani, Andamion Murataj dhe Shqiponja Dauti, Ilir Butka, Leonard Bombaj, Shoqata e kinematografisë, One Albania, AmCham.

5. Pasqyra e komenteve të pranuara me arsyetimin e komenteve të pranuara/ refuzuara

Gruponi komentet/ propozimet e pranuara sipas çështjes që ato ngritën;
Gruponi komente të ngjashme së bashku dhe renditni palët e interesuara që i ngritën ato;
Shpjegoni cili ishte vendimi i marrë dhe sqaroni shkurtimisht arsyet për të.

Gjatë procesit të konsultimit publik për projektligjin "Për kinematografinë dhe audiovizualin", sipas tabelës së komenteve të grupuara, janë shqyrtuar gjithsej 46 komente/çështje, nga të cilat 18 janë pranuar plotësisht, 10 janë pranuar pjesërisht dhe 18 janë refuzuar.
Sa i përket kategorizimit të komenteve të refuzuara, nga shqyrtimi i arsyetimeve të pasqyruara në raport, rezulton se:

1. Jashtë objektit të projektaktit: Nuk rezultojnë komente të refuzuara shprehimisht për këtë arsye (0 të identifikuara).
2. Jashtë kompetencës së institucioneve të qeverisjes qendrore: Nuk rezultojnë komente të refuzuara shprehimisht për këtë arsye (0 të identifikuara).
3. Çështje që gjejnë zgjidhje në një akt tjetër ligjor/nënligjor: Janë identifikuar 2 komente të refuzuara, të cilat lidhen me mekanizmat e detajuar të transparencës institucionale dhe përcaktimin e peshës së kritereve të vlerësimit të veprave kinematografike. Këto çështje parashikohen të rregullohen nëpërmjet akteve nënligjore në zbatim të ligjit.
4. Mospërputhje me procedurat ose afatet e institucioneve të Bashkimit Evropian në kuadër të acquis që transpozohet: Nuk rezultojnë komente të refuzuara shprehimisht për këtë arsye (0 të identifikuara).

16 komentet e tjera të refuzuara, kanë arsyetime të ndryshme, që lidhen kryesisht me kuadrin ligjor në fuqi, organizimin institucional, rregullat buxhetore dhe zgjidhjet rregullatore të parashikuara në projektligj. Këto nuk rezultojnë të klasifikueshme drejtpërdrejt në katër kategoritë e mësipërme, bazuar në arsyetimet e dokumentuara.

Pasqyra e komenteve dhe vendimmarrja pwr secilin prej tyre paraqitet mw poshtw:

Çështja e adresuar (psh. përkufizimi i ri i…, kushtet për regjistrimin e…, rregullimi i…, etj.)	Komenti (grumbulloni dhe përmblidhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)	Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
Autonomia e AKKA	Krijimi i AKKA-së, agjenci, jo institucion në varësi të ministrisë përgjegjëse për kulturën	Bujar Alimani, Andamion Murataj	Refuzuar	Në zbatim të ligjit Nr. 90/2012 “Për Organizimin Dhe Funksionimin E Administratës Shtetërore”, institucionet

				qendrore janë në varësi të një ministrie ose të Kryeministrisë
Ndarja e buxhetit që shkon për sektorin e kinematografisë dhe për sektorin e audiovizualit	Duke qenë se Agjencia do të mbështesë si krijimtarinë kinematografike ashtu edhe atë audiovizuale, është e nevojshme që në ligj mekanizma të qartë për shpërndarjen e fondeve ndërmjet këtyre dy sektorëve. Si parim, jo më pak se 60% e fondit vjetor të mbështetjes për krijimtarinë duhet të destinohet për kinematografinë, ndërsa pjesa tjetër mund të alokohet për veprat dhe programet audiovizuale sipas prioriteteve të Programit Kombëtar. Ky mekanizëm do të siguronte që zhvillimi i sektorit audiovizual të mos cënojë misionin themelor kulturor të Agjencisë: mbështetjen e kinemasë së autorit.	Shoqatat "APFA", "AWA" individët Florenc Papas.	Pranuar	Ky koment është refleturar si më poshtë: Neni 8 Burimet e financimit të QKKA 2. Nga fondi vjetor i miratuar për mbështetjen e projekteve, 70 përqind destinohet për projektet kinematografike dhe 30 përqind për projektet audiovizuale. Kjo ndarje zbatohet në përputhje me buxhetin e miratuar dhe rregullat për administrimin e fondeve publike. Ligji përcakton parimet dhe kornizën e përgjithshme, ndërsa detajet procedurale dhe mekanizmat konkretë të funksionimit do të specifikohen në aktet

				nënligjore përkatëse.
Transparenca institucionale, parashikimi i detajuar i mekanizmave që rregullojnë trasnparencë, publikimet e procedurave të thirrjeve për mbështetje financiare.	Propozimi i disa elementeve si: publikimi I vendimeve, procesverbaleve të KD dhe KA, regjistri publik i deklarimeve të konfliktit të interesave, publikimi i thirrjeve për mbështetje financiare për projektet kinematografike dhe audiovizuale dhe e gjitha procedura që do të ndiqet deri në marrjen e vendimeve.	Shoqata "AWA"	Refuzuar	Për sa i përket pikave të propozuara, vlerësojmë se ato synojnë rritjen e transparencës, llogaridhënies dhe integritetit institucional. Megjithatë, një pjesë e konsiderueshme e elementeve të sugjeruara, si procedurat e publikimit, format e deklarimit të konfliktit të interesit, mekanizmat e ankimimit, si dhe kriteret dhe procedurat e detajuara të përzgjedhjes, përbëjnë mekanizma zbatues që parashikohen të rregullohen me aktin nënligjor në zbatim të ligjit. Në këtë kuadër, ligji përcakton parimet dhe kornizën e

				përgjithshme, ndërsa detajet procedurale dhe mekanizmat konkretë të funksionimit do të specifikohen në aktet nënligjore përkatëse, duke garantuar njëkohësisht respektimin e legjislacionit në fuqi për transparencën, konfliktin e interesit, konsultimin publik dhe të drejtën e ankimit.
Kriteret e vlerësimit të filmave autorialë, proporcionaliteti dhe përparësia për cilësinë artistike	Të përcaktohet në nenin 22 se, për kategoritë e kinemasë — veçanërisht veprën autoriale dhe atë debutuese e të dytë — kriteri i cilësisë artistike dhe i vlerës kulturore ka peshë mbizotëruese në vlerësimin total. (ii) Të ankorohen drejtpërdrejt në ligj — dhe jo vetëm në Programin Kombëtar — masat	Shoqata "AWA", individi (kineast) Florenc Papas	Refuzuar	Është e rëndësishme të theksohet se neni 22 përcakton kriteret e përgjithshme që merren në konsideratë gjatë vlerësimit të projekteve, por përcaktimi i këtyre kritereve nuk nënkupton që ato do të kenë të njëjtën peshë për çdo kategori mbështetjeje

	e posaçme dhe kuotat e garantuara për kinemanë autoriale, veprat debutuese e të dyta, si dhe për barazinë gjinore. (iii) Të përkufizohet parimi i proporcionalitetit në mënyrë funksionale.			apo për çdo lloj projekti. Pesha dhe rëndësia relative e secilit kriter do të përcaktohen në aktin nënligjor, duke marrë parasysh specifikat e kategorive të ndryshme të projekteve. Për rrjedhojë, në rastin e kinemasë autoriale, kriteret që lidhen me cilësinë artistike, origjinalitetin e projektit, vizionin regjisorial, dramaturgjinë dhe vlerën kulturore mund të kenë një peshë më të madhe në procesin e vlerësimit, ndërsa kriteret si ndikimi ekonomik, potenciali për punësim, niveli i bashkëprodhimi t ndërkombëtar apo potenciali i

				qarkullimit ndërkombëtar do të vlerësohen në përputhje me natyrën dhe objektivat e kësaj kategorie. Në këtë kuptim, neni 22 synon të sigurojë një kornizë të plotë kriteresh vlerësimi, ndërsa balancimi dhe peshimi i tyre do të rregullohen në mënyrë më të detajuar në aktet nënligjore.
Albafilm sh.a. – monopol shtetëror; eliminim	Në rast se parashikohet që AKKA të jetë zotërues i kapitaleve të Albafilm Sh.A., mendoj se është e gabuar që neni 32 të jetë nën Kreu VI "Bashkëpunimi ndërinstitucional". … duhet të rishikohen përcaktimet e pikave 4 dhe 5 të Nenit 32, pasi bie ndesh me parimet e konkurrencës së lirë dhe të ndershme, vendosjen e	Andamion Murataj, Shqiponja Dauti, APFA	Pranuar	Komenti është marrë në konsideratë dhe është reflektuar në versionin e rishikuar të dokumentit, nëpërmjet heqjes së nenit përkatës. Qëllimi i formulimit të këtij neni është të krijojë një mekanizëm mbështetës për prodhimet kinematografike, duke nxitur zhvillimin e sektorit dhe

	monopolit shtetëror, etj.			rritjen e cilësisë së prodhimeve, pa cenuar parimet e konkurrencës së lirë në treg. Në këtë kuadër, mbështetja nuk parashikohet në formën e financimit të drejtpërdrejtë, por në formën e ndihmës teknike, e cila synon të lehtësojë realizimin e projekteve dhe të përmirësojë kapacitetet profesionale e operacionale të subjekteve përfituese. Kjo qasje siguron që mbështetja të mos krijojë avantazhe të padrejta konkurruese, duke ruajtur njëkohësisht objektivin e promovimit dhe zhvillimit të industrisë kinematografike. Do të rishikohet formulimi I kalimit të pronësisë nga

				MTKS te AKKA.
Buxheti i AKKA-së	Në përmbledhje, modeli shqiptar rrezikon të zbehë të drejtat ekskluzive të autorit, duke krijuar konfuzion.	DDA	Pranuar	Parashikimi i buxhetit ndryshohet. Neni 8 Burimet e Financimit të QKKA janë: a) fondet nga buxheti i shtetit, të parashikuara çdo vit si zë i veçantë buxhetor për Qendrën Kombëtare të Kinematografisë dhe Audiovizualit. b) fondet e përfituara nga programe dhe projekte kombëtare ose ndërkombëtare, në përputhje me kushtet e financimit; c) të ardhurat nga tarifat, shërbimet dhe veprimtaritë e ligjshme të QKKA-së; ç) donacionet, sponsorizimet, të pranuara dhe të administruara në përputhje me legjislacionin në fuqi;

				d) të ardhura të tjera të ligjshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
Direktiva BE 2010/13	Përmbajtja e projektligjit në përputhje me Direktivën e BE-së 2010/13	DDA	Pranuar	U modifikua: Neni 3 Fusha e zbatimit 1. Ky ligj zbatohet për krijimin, zhvillimin, prodhimin, mbështetjen financiare, promovimin, shpërndarjen dhe shfaqjen kinematografike të veprave kinematografike dhe audiovizuale, subjektet që ushtrojnë këto veprimtari, si dhe për institucionet dhe organet përgjegjëse për zbatimin e tij. 2. Ky ligj nuk zbatohet për veprimtaritë që rregullohen nga ligji për mediat audiovizive. 3. Dispozitat e këtij ligji

				zbatohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për të drejtën e autorit dhe të drejtat e lidhura me të, mediat audiovizive, konkurrencën, ndihmën shtetërore, menaxhimin financiar dhe kontrollin, sistemin buxhetor, trashëgiminë kulturore dhe mbrojtjen e të dhënave personale. 4. Për bashkëprodhimet ndërkombëtare zbatohen marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë. Dispozitat e këtij ligji nuk cenojnë statusin dhe trajtimin që rrjedhin nga këto marrëveshje.
Leja e Qarkullimit	Detyrimi i distributorëve për subtitrim ose	TRING-216	Refuzuar	Nuk është detyrim absolut dublimi apo

	dublim, dispozita nuk merr në konsideratë natyrën ndërkombëtare të përmbajtjes audiovizive, përmbajtjet sportive, festivalet tematike…			subtitrimi. Përjashtimi është në pikën si më poshtë " 10. Distributori paraqet kopjen e veprës kinematografike dhe audiovizuale, e cila duhet të jetë identike me kopjen që do të qarkullojë. 11. Distributori është i detyruar të përgatisë veprën kinematografike dhe audiovizuale të dubluar ose të subtitruar në gjuhën shqipe. Ndalohet lëshimi i lejes për veprat që nuk plotësojnë këtë kusht. Përjashtohen nga ky detyrim veprat kinematografike dhe audiovizuale që shfaqen gjatë festivaleve të filmit, javëve kulturore ose eventeve të veçanta të miratuara nga QKKA.

Mbivendosje me AMA-n	Komisioni i Vizionimit – mbivendosje me AMA	TRING-216	Refuzuar	Referuar ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë|(i ndryshuar), neni 19, një nga funksionet e AMA-s është "AMA monitoron tërësinë e programeve të transmetuara nga OSHMA-të.". Kjo do të thotë se monitoron përmbajtjen e transmetimit, qoftë vepër kinematografike apo audiovizuale, pa e licensuar.
Probleme teknike	Probleme teknike, gramatike	Shqiponja Dauti	Pranuar	Rishikohen gabimet gramatike, teknike apo referenca jo të sakta.
Taksim i dyfishtë, rritja e detyrimeve dhe mungesa e lidhjes ISP-industri	Mungesë përputhjeje me kompetencat e AKKA-s (Neni 5), të përshkruara në dokument, (ku citohet se Agjencia financon prodhimet, ofron	ONE Albania, DDA	Pranuar	Komenti është marrë në konsideratë dhe është reflektuar në versionin e rishikuar të projektligjit, përkatësisht

	grante dhe zbaton skema rimbursimi për filma/seriale etj.), dhe rolit të saj në aspekt të subjekteve ISP apo ofrues shërbimesh elektronike të cilëve referon t'ju mbledhë të ardhura për fondin e buxhetit të saj			neni 8 dhe neni 9.
Kundërshtim parimor – ndërhyrje në treg & autonomi	Rikthimin e projektligjit për punim nga grupi i punës.	Andamion Murataj	Pranuar pjesërisht	Modeli aktual, ku QKK ushtron kryesisht funksione financuese dhe koordinuese, QKKA konceptohet si një institucion publik me kompetenca të zgjeruara për hartimin dhe zbatimin e politikave kombëtare, administrimin e fondeve publike, mbështetjen financiare, certifikimin e shpenzimeve të kualifikuara dhe koordinimin e mekanizmave të funksioneve të saj të reja, të cilat përfshijnë hartimin dhe zbatimin e

				politikave zhvillimore, mbështetjen e prodhimit dhe promovimit, si dhe përfaqësimin ndërkombëtar të industrisë shqiptare kinematografike dhe audiovizuale, administrimin e skemës së rimbursimit të shpenzimeve (cash rebate) , ky institucion synon të shndërrohet në një instrument efektiv të politikës publike në fushën e industrive kreative. Projektiligj do të ketë ndryshime në disa nene.
Skema Cash Rebate – përfituesi subjekt vendas	Përfituese të Skemës (Cash Rebate) janë shtëpitë kinematografike të regjistruara në Republikën e Shqipërisë, të cilat realizojnë projekte audiovizuale në bashkëpunim me	Shoqata "APFA"	Pranuar pjesërisht	Modifikohet si më poshtë: 6. Përfituese të skemës së Rimbursimit të Shpenzimeve (Cash Rebate) janë prodhimet kinematografike dhe audiovizuale

	shtëpi kinematografike të huaja dhe kryejnë shpenzime të kualifikuara në territorin e Republikës së Shqipërisë.			kombëtare ose ndërkombëtare, të cilat realizohen në territorin e Republikës së Shqipërisë në bashkëpunim me një shtëpi kinematografike ose subjekt juridik të regjistruar në Republikën e Shqipërisë dhe që kryejnë shpenzime të kualifikuara në territorin e Republikës së Shqipërisë. Aplikimi, administrimi i dokumentacionit dhe pagesa e rimbursimit kryhen vetëm në favor të subjektit juridik të regjistruar në Republikën e Shqipërisë.
Fondi Cash Rebate – garantimi dhe bartja	Projektligji e lë përcaktimin e vlerës së fondit vjetor për t'u bërë vit pas viti përmes procesit të buxhetit të shtetit, pa një prag minimal të garantuar, dhe	MPA	Refuzuar	Në zbatim të nenit 5, pika 5 të ligjit nr. 9936/2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të

	parashikon shprehimisht se fondet e pashpërndara humbasin në fund të vitit në vend që të mbarten			ndryshuar, Buxheti i Shtetit nuk mund të trashëgohet nga njëri vit në tjetrin, përveç rasteve të përcaktuara në këtë ligj. Vlera vjetore e Fondit të Rimbursimit të Shpenzimeve përcaktohet çdo vit në ligjin vjetor për buxhetin e shtetit (neni 20, pika 2), duke marrë parasysh parashikimin e kërkesave nga sektori dhe kapacitetet fiskale të buxhetit të shtetit.
Mungesa e RIA-s, pronësia e filmit	Mungesa e RIA-s, pronësia e produktit të financuar (plotësisht , pjesërisht) nga AKKA-s	Shqiponja Dauti	Pranuar	RIA e thjeshtuar është dërguar. Pronësia, në zbatim të ligjit nr.35/2026 "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e lidhura me to" (i ndryshuar), do të përcaktohet në aktin nënligjor në zbatim të këtij ligji.

Cash rebate	Përfitues të jenë jo vetëm shtëpitë kinematografike të huaja, por edhe ato shqiptare		Pranuar	Cash Rebate është një mekanizëm që nxit realizimin e xhirimeve të prodhimeve kinematografike dhe audiovizuale në R.SH, sidomos prodhimet e huaja. Rritja e numrit të prodhimeve të realizuara në territorin shqiptar gjeneron jo vetëm përfitime të drejtpërdrejta ekonomike gjatë fazës së xhirimeve, si rritje e kërkesës për punësim lokal, shërbime teknike, akomodimi, transporti dhe logjistike, porprodhon gjithashtu një efekt shumëplanësh afatgjatë në ekonomi dhe imazh kombëtar.
Neni 4, pika d) - Distributor	Përkufizimi i "Distributorit" të kufizohet vetëm te personat juridikë,	TV KLAN	Refuzuar Ruhet formulimi	Në tregun e vogël shqiptar një pjesë e shpërndarjes,

	pasi shpërndarja është veprimtari sipërmarrëse që kërkon kapacitete të papërshtatshme për persona fizikë.		"personi fizik ose juridik".	sidomos për filmin autorial, dokumentarin dhe qarkullimin festivalor, kryhet nga persona fizikë; kufizimi vetëm te personat juridikë do t'i përjashtonte këta operatorë legjitimë. Ligji kroat për veprimtaritë audiovizuale, neni 28, e mban "personin fizik ose juridik" të shoqëruar me regjistrim. Shqetësimi për kapacitetet adresohet me regjistrimin, jo me përjashtimin e personave fizikë.
Neni 4, pika i - Profesionist i industrisë	Përcaktohet përkufizim i përbashkët për "Profesionist i industrisë kinematografike dhe audiovizuale", ndaj është i pashpjegueshëm dallimi i përfaqësimit në Këshillin Drejtues (2 anëtarë për	Shqiponja Dauti	Pranuar pjesërisht	Përkufizimi i profesionistit mbetet i përbashkët, pasi i njëjti profesionist mund të punojë si në kinematografi, ashtu edhe në audiovizual. Formulimi “individi ose personi fizik”

	kinematografinë, 1 për audiovizualin).			saktësohet në “personi fizik”. Këshilli Drejtues është hequr nga projektligji. Dallimi ndërmjet kinematografisë dhe audiovizualit shfaqet te Këshillat e Miratimit të Projekteve (neni 12), ku numri i ndryshëm i anëtarëve (7 për kinematografinë, 3 për audiovizualin) pasqyron peshën parësore të kinematografisë në mbështetjen financiare. Përzgjedhja e anëtarëve nga komuniteti profesional përkatës dhe procedura e votimit përcaktohen në rregulloren e parashikuar në nenin 12, pika 14.
Neni 4, pikat g, bb, cc - mbivendosje	Përkufizimet e "filmit" (g), "veprës audiovizuale" (bb)	Shqiponja Dauti	Refuzuar	Përkufizimet e filmit (pika dh), veprës audiovizuale

përkufizimesh Në projektligjin e rishikuar, pikat g, bb dhe cc janë rinumërtuar si pikat dh, q dhe r.	dhe "veprës audiovizuale ndërvepruese" (cc) janë të ndërthurura dhe mbivendosen konceptualisht; numri i lartë i përkufizimeve dëshmon mungesë filtrimi ligjor.			(pika q) dhe veprës audiovizuale ndërvepruese (pika r) nuk mbivendosen, pasi secili ka element dallues. Filmi realizohet si krijim i vetëm dhe destinohet për shfaqje publike. Vepra audiovizuale mund të jetë krijim unitar ose serial dhe destinohet kryesisht për shfaqje nëpërmjet mjeteve televizive ose platformave elektronike apo digjitale. Vepra audiovizuale ndërvepruese dallohet nga natyra ndërvepruese e përmbajtjes, ku zhvillimi varet nga ndërveprimi i përdoruesit. Numri i përkufizimeve ruhet, pasi secili prej termave përdoret në dispozitat e ligjit.

Neni 4, pika bb) - Vepër audiovizuale Në projektligjin e rishikuar, pika bb është rinumërtuar si pika q.	Të riformulohet përkufizimi për të dalluar qartë veprën audiovizuale kinematografike nga veprat televizive (OSHMA) dhe të shtohet elementi i destinimit për shfaqje në kinema.	TV KLAN	Refuzuar	Dallimi i kërkuar parashikohet tashmë në projektligj nëpërmjet përkufizimeve të veçanta. Vepra audiovizuale (pika q) është vepra e destinuar kryesisht për shfaqje nëpërmjet mjeteve televizive ose platformave elektronike apo digjitale. Filmi ose vepra kinematografike (pika dh) përkufizohet më vete si krijim i vetëm, i destinuar për shfaqje publike. Shfaqja në kinema rregullohet nëpërmjet përkufizimit të sallës së shfaqjes kinematografike (pika ll) dhe lejes së qarkullimit (neni 26). Për pasojë, nuk nevojitet

				riformulimi i pikës q.
Neni 4, pikat k & z - Producent / Shtëpi kinematografike Në projektligjin e rishikuar, pikat k dhe z janë rinumërtuar si pikat g dhe p, ndërsa neni 27 si neni 22.	Përkufizimi i njëjtë, pa dallim esencial, i termave "Producent" dhe "Shtëpi kinematografike"; përsëritje e panevojshme me nenin 27, pika 1.	Shqiponja Dauti	Pranuar	Dallimi ndërmjet dy termave qartësohet. Producenti (pika g) është individi që mban përgjegjësinë profesionale për zhvillimin, organizimin, financimin dhe realizimin e veprës. Shtëpia kinematografike (pika p) është personi fizik ose juridik që organizon, menaxhon dhe mbështet financiarisht procesin e prodhimit dhe gëzon të drejtat e shfrytëzimit ekonomik të veprës. Neni 22, pika 1 nuk e përsërit përkufizimin, por rregullon marrëdhënien ndërmjet tyre: shtëpia kinematografike mund të ketë një ose më shumë producentë, të cilët veprojnë në

				emër dhe për llogari të saj.
Kreu III / Neni 19 - Komisioni Shqiptar i Filmit (heqje) Në projektligjin e rishikuar, neni 19 është rinumërtuar si neni 15.	Pika 3 sanksionon "pa kompetenca vendimmarrëse financiare të pavarura"; struktura zhvishet nga çdo autonomi dhe mbetet fiktive, ndaj kapitulli duhet të hiqet tërësisht. Referencë: Apulia Film Commission, institucion i pavarur rajonal me buxhet ~5 mln euro/vit.	Andamion Murataj	Refuzuar	Krahasimi me Apulia Film Commission nuk vlen për Shqipërinë: komisionet rajonale financohen përmes skemave e institucioneve rajonale që te ne nuk ekzistojnë, ndaj financimi do të vinte sërish nga buxheti i shtetit dhe do të krijonte dy institucione në të njëjtën fushë, të vështira për t'u mbajtur në një sektor të vogël. Vendosja brenda QKKA-së nuk e bën Komisionin fiktiv, por të zbatueshëm, duke shfrytëzuar kapacitetet e QKKA-së. Me shqyrtimin e pranueshmërisë formale dhe verifikimin teknik të dokumentacionit dhe të shpenzimeve të deklaruara në

				kuadër të skemës së rimbursimit të shpenzimeve (neni 15, pika 2, shkronjat d dhe dh), roli i tij bëhet më i plotë.
Kreu III / Neni 19 - Komisioni jashtë AKKA-s Në projektligjin e rishikuar, neni 19 është rinumërtuar si neni 15.	Komisioni, siç konceptohet, nuk është Film Commission sipas modelit ndërkombëtar; shërbimi logjistik për prodhimet e huaja i takon një Film Commission të pavarur, të decentralizuar rajonalisht dhe të pozicionuar jashtë AKKA-s (lidhet me Nenin 25).	Shqiponja Dauti	Refuzuar	Modeli i pavarur dhe i decentralizuar rajonalisht mbështetet në burime financimi rajonale që në Shqipëri nuk ekzistojnë; financimi do të vinte sërish nga buxheti i shtetit. Decentralizimi nuk i përshtatet një vendi të vogël, ku ndarja e burimeve do të dobësonte të dyja strukturat. Komisioni Shqiptar i Filmit, i krijuar vite më parë, nuk funksionoi kurrë realisht për mungesë financimi të qëndrueshëm. Vendosja brenda QKKA-së i jep kapacitetin operacional që si

				strukturë e pavarur nuk do ta kishte.
Kreu III / Neni 19 - Albania Film Commission jashtë AKKA-s	Parashikimi si strukturë në varësi të Agjencisë rrezikon të devijojë nga misioni kryesor i një Film Commission (promovimi i territorit, tërheqja e investimeve, zhvillimi ekonomik); kufizimi si njësi administrative brenda Agjencisë redukton efektivitetin.	APFA	Pranuar pjesërisht	Misioni i promovimit të territorit dhe tërheqjes së investimeve pranohet dhe parashikohet shprehimisht në nenin 15, pika 1; Komisioni nuk reduktohet në administrim skemash. Por pavarësia jashtë Agjencisë nuk është e qëndrueshme në kontekstin shqiptar: komisionet që ruajnë këtë mision financohen përmes skemave rajonale që te ne nuk ekzistojnë, ndaj financimi do të vinte nga buxheti i shtetit dhe do të krijonte dy institucione në të njëjtën fushë. Brenda QKKA-së,, Komisioni ruan misionin promovues dhe përfiton nga kapacitetet

				administrative e financiare të QKKA-së.
Kreu III / Neni 19 (dhe Koment i pgj) - Albania Film Commission autonome (Në projektligjin e rishikuar, neni 19 është rinumërtuar si neni 15.)	Propozim i hollësishëm për "Albania Film Commission" si institucion publik autonom me bord, drejtor ekzekutiv, departamente, financim të kombinuar (shtet, burime rajonale, fonde evropiane) dhe rol certifikues për Cash Rebate/Tax Credit/Tax Shelter; model hibrid i pavarur nga QKK/AKKA. Shoqëruar me Memorandum Shpjegues.	Ilir Butka	Pranuar pjesërisht	Një pjesë e funksioneve të propozuara janë integruar në projektligj: nxitja e investimeve dhe promovimi i Republikës së Shqipërisë si destinacion xhirimi (neni 15, pika 1 dhe pika 2, shkronja b), informimi dhe asistenca për producentët vendas dhe të huaj (neni 15, pika 2, shkronja a), asistenca dhe koordinimi me autoritetet kompetente për lejet e xhirimit (neni 15, pika 2, shkronja e, dhe neni 16), si dhe shqyrtimi i pranueshmërisë formale dhe verifikimi teknik i shpenzimeve në kuadër të skemës së rimbursimit të shpenzimeve (neni 15, pika 2,

				shkronjat d dhe dh). Krahasimi me Apulia nuk i përshtatet rastit shqiptar: ajo administron fond të madh prodhimi ~5 mln euro, të bashkëfinancuar nga fonde rajonale e evropiane që në Shqipëri nuk ekzistojnë. Komisioni Shqiptar i Filmit nuk ka fond për prodhime dhe nuk shpërndan grante; është strukturë vetëm operacionale, prandaj integrohet brenda QKKA-së për qëndrueshmëri financiare.
Neni 20 - Sistemi Kombëtar i Lejeve të Xhirimit (Në projektligjin e rishikuar, neni 20 është rinumërtuar si neni 16.)	Të përcaktohet qartë nëse sistemi funksionon si platformë elektronike e centralizuar; nëse aplikimet, ndjekja e statusit dhe komunikimet realizohen elektronikisht; si dhe të parashikohen	AKSHI	Pranuar pjesërisht	Projektligji nuk krijon një sistem kombëtar të lejeve të xhirimit. Komisioni Shqiptar i Filmit shqyrton kërkesat për pajisje me leje xhirimi dhe asiston kërkuesit në procedurat

	afatet, njoftimi dhe gjurmueshmëria e procesit administrativ.			për marrjen e lejeve nga autoritetet kompetente (neni 16, pikat 1 dhe 2), si funksion lehtësues, pa cenuar kompetencat e parashikuara nga legjislacioni i posaçëm. Sugjerimi për funksionim elektronik, afate, njoftim dhe gjurmueshmëri pranohet në parim: mënyra e paraqitjes dhe administrimit të kërkesave, afatet e shqyrtimit dhe njoftimet përcaktohen në rregulloren e parashikuar në nenin 16, pika 3.
Neni 23 - Përfituesi vendas vs. i huaj (Cash Rebate) (Në projektligjin e rishikuar, neni 23, pika 4 është rinumërtuar	Brenda nenit 23/4 ka përcaktime të kundërta: përfituese janë shtëpitë e huaja, por aplikimi e rimbursimi kryhet në favor të shtëpisë vendase. Nuk ka arsye ligjore që rimbursimi të kalojë përmes një	Andamion Murataj	Refuzuar	Nuk ka kontradiktë në nenin 19, pika 6. Përfituese të skemës janë prodhimet kinematografike dhe audiovizuale kombëtare ose ndërkombëtare, pa dallim, të

si neni 19, pika 6.)	kompanie vendase; është diskriminues për investitorët vendas. Kushdo, vendas apo i huaj, të rimbursohet drejtpërdrejt.			cilat realizohen në bashkëpunim me një shtëpi kinematografike ose subjekt juridik të regjistruar në Republikën e Shqipërisë. Pagesa e rimbursimit kryhet në favor të subjektit të regjistruar në Shqipëri, për të lidhur fondin publik me një tatimpagues shqiptar të kontrollueshëm nga QKKA-ja. Ky është modeli standard i skemave të rimbursimit.
Neni 23 - Shpenzimet e kualifikuara (punë jo-shqiptare & pajisje) (Në projektligjin e rishikuar, neni 23 është rinumërtuar si neni 19.)	Të lejohet një pjesë e përcaktuar e kostove të punës jo-shqiptare të kualifikohet nën program; përjashtimi i tyre do të hollonte normën efektive të rimbursimit. Të qartësohet trajtimi i kostove të pajisjeve të specializuara që nuk gjenden në vend, kur blihen përmes një	MPA	Pranuar	Projektligji përcakton kategoritë kryesore të shpenzimeve të kualifikuara në mënyrë jo shteruese (neni 19, pika 4). Shpenzimet për personelin artistik, teknik dhe profesional të angazhuar në Republikën e Shqipërisë kualifikohen

	kompanie shqiptare të regjistruar.			pavarësisht shtetësisë (neni 19, pika 4, shkronja a). Shpenzimet për pajisje të specializuara, kur sigurohen përmes një subjekti të regjistruar në Republikën e Shqipërisë, konsiderohen shpenzime të kryera në territorin e saj. Pjesa e lejuar e këtyre kostove, kategoritë e tjera të shpenzimeve të kualifikuara dhe të përjashtuara, si dhe kushtet e hollësishme përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave sipas nenit 19, pika 7, në draftin specifik të skemës, në një fazë të mëpasme.
Neni 23 - Përfituesi subjekt vendas (sqarim)	Përfituese janë shtëpitë e regjistruara në RSH që realizojnë projekte në bashkëpunim me	APFA	Pranuar pjesërisht	Sipas nenit 19, pika 6, përfituese të skemës janë prodhimet kinematografike

(Në projektligjin e rishikuar, neni 23, pika 4 është rinumërtuar si neni 19, pika 6.)	shtëpi të huaja dhe kryejnë shpenzime të kualifikuara në territor. Investimet e partnerëve të huaj konsiderohen pjesë e projektit të realizuar përmes subjektit shqiptar, i cili është përfituesi, aplikuesi dhe subjekti në favor të të cilit kryhet rimbursimi.			dhe audiovizuale kombëtare ose ndërkombëtare që realizohen në bashkëpunim me një shtëpi kinematografike ose subjekt juridik të regjistruar në Republikën e Shqipërisë, ndërsa pagesa e rimbursimit kryhet në favor të subjektit të regjistruar në Shqipëri. Sqarimi pranohet për sa i përket subjektit vendas si marrës i pagesës. Procedura e aplikimit dhe roli i subjektit vendas në të përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave sipas nenit 19, pika 7.
Neni 24 - Garantimi dhe bartja e Fondit të Cash Rebate (Në projektligjin e rishikuar,	Rekomandohej alokim vjetor i garantuar dhe i mjaftueshëm, me angazhim 10-vjeçar dhe fleksibilitet bartjeje për fondet e pashpenzuara.	MPA	Refuzuar	Sipas nenit 5, pika 5 të ligjit nr. 9936/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të

neni 24 është rinumërtuar si neni 20.)	Drafti e lë vlerën vjetore të përcaktohet vit pas viti, pa dysheme të garantuar, dhe parashikon që fondet e paalokuara humbin në fund të vitit. Siguria buxhetore është themel i çdo regjimi konkurrues incentivash.			ndryshuar, Buxheti i Shtetit nuk mund të trashëgohet nga njëri vit në tjetrin, përveç rasteve të përcaktuara në këtë ligj; për këtë arsye një angazhim 10-vjeçar dhe një dysheme e garantuar nuk mund të fiksohen në ligj. Vlera vjetore e Fondit të Rimbursimit të Shpenzimeve përcaktohet çdo vit në ligjin vjetor për buxhetin e shtetit (neni 20, pika 2), në përputhje me parashikimin e të ardhurave dhe aftësinë thithëse të prodhimeve, e cila ka shumë variabla. Fondi krijohet si zë i veçantë në buxhetin vjetor të QKKA-së (neni 20, pika 1), çka i jep parashikueshmëri e qëndrueshmëri skemës brenda

				kuadrit buxhetor në fuqi. Fondet e akorduara mund të rialokohen në përputhje me legjislacionin për menaxhimin e sistemit buxhetor (neni 20, pika 2).
Koment i përgjithshëm - Mbështetje për skemën & konsultim i mëtejshëm (Në projektligjin e rishikuar, neni 23 është rinumërtuar si neni 19.)	Vlerësohet miratimi i mekanizmit të rimbursimit, norma 35%, afati 90-ditor i pagesës, përfshirja e serialeve dhe formateve episodike, mbulimi i filmave të shkurtër, dokumentarëve dhe animacionit. Kërkohet një konsultim tjetër publik për draft-rregulloren (shpenzimet e kualifikuara, dritarja 180-ditëshe, klauzola sunset, etj.).	MPA	Pranuar	Drafti specifik i skemës së rimbursimit hartohet dhe miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave sipas nenit 19, pika 7, në një fazë të mëpasme, ku do të trajtohen detajet e shpenzimeve të kualifikuara, procedurat dhe afatet, përfshirë afatin e pagesës dhe dritaren kohore, si dhe elementet e tjera teknike. Projektvendimi i nënshtrohet konsultimit publik në përputhje me ligjin nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik".

Neni 6 - Buxheti Pavarësia - buxheti si zë më vete & ring-fencing.	Propozim: të shtohet në nenin 6 një dispozitë që mbështetja financiare e AKKA-s… paraqitet si zë më vete në buxhetin e shtetit, e veçuar nga shpenzimet administrative dhe e mbrojtur nga rishpërndarja. Gjithashtu, propozohet ndarje strukturore (ring-fencing) ndërmjet fondit të kinemasë dhe atij të audiovizualit, me kuota minimale të garantuara; Nëse AKKA varet nga ministria e bën ligjërisht të pamundur që të ardhurat e përcaktuara në shkronjën 'b' të pikës 1 të nenit 6 të derdhen në një llogari të veçantë të AKKA-së. Rikthimin e formulimit “Fondi buxhetor i përcaktuar me zë më vete në Buxhetin e Shtetit”	AWA Andamion Murataj APFA AWA	Pranuar	Buxheti i QKKA-së, burim kryesor ka fondet nga buxheti i shtetit, pikë e cila në draftin përfundimtar është ndryshuar si vijon: “Burimet e Financimit të QKKA janë: a) fondet nga buxheti i shtetit, të parashikuara çdo vit si zë i veçantë buxhetor për Qendrën Kombëtare të Kinematografisë dhe Audiovizualit.”. Sa i takon ndarjes së mbështetjes financiare, për kinematografinë dhe audiovizualin, në nenin 8, pika 2 të draftit përfundimtar është parashikuar se, nga fondi vjetor i miratuar për mbështetjen e projekteve, 70 përqind destinohet për projektet

	(Neni 6 – Buxheti i AKKA pika 1.a). Propozim: të shtohet në nenin 6 (ose në nenin 21, "Instrumentet e mbështetjes financiare") një dispozitë: "Jo më pak se 60% e fondeve vjetore të mbështetjes financiare të AKKA-s i dedikohet prodhimit të veprave kinematografike.			kinematografike dhe 30 përqind për projektet audiovizuale. Kjo ndarje zbatohet në përputhje me buxhetin e miratuar dhe rregullat për administrimin e fondeve publik.
Neni 5 - Kompetencat -miksim funksionesh.	Neni 5 i ngarkon AKKA-s kompetenca dhe përbërje strukturore heterogjene. … grumbullimi i funksionit normativ, atij zbatues dhe atij inspektues-sanksionues brenda të njëjtit organ, krijon konflikt të brendshëm institucional. … Projektligji i lejon AKKA-s edhe të "promovojë, programojë shpërndarjen…" (shkronja j), duke u	Shqiponja Dauti	Pranuar	Kompetencat e QKKA-së janë parashikuar në përputhje me misioni dhe qëllimin e saj të krijimit. Referuar shkronjës j, pika 1, neni 5, është reflektuar i ndryshuar si vijon: "Mbështet promovimin, shpërndarjen dhe qarkullimin e veprave kinematografike dhe audiovizuale shqiptare në tregjet

	bërë njëkohësisht rregullator dhe aktor tregu.			kombëtare dhe ndërkombëtare” .
Neni 6 – Buxheti, pika 1, shkronja b (i) – 5% të tatim-fitimit nga subjektet që ofrojnë përmbajtje audiovizuale .	Detyrimi i propozuar përbën një barrë financiare shtesë për OSHMA-të pa u shoqëruar me një analizë të qartë të ndikimit ekonomik dhe pa pasur një proces paraprak konsultimi me subjektet që preken drejtpërdrejt nga ky detyrim. Sugjerojmë që mekanizmi i përcaktimit të tarifave të parashikohet vetëm pas një procesi formal konsultimi me subjektet që do të mbajnë barrën financiare të tyre. Në mungesë të një konsultimi të tillë, miratimi i tarifave me vendim të Këshillit të Ministrave kufizon mundësitë për adresimin e shqetësimeve të industrisë.	TV KLAN TRING-216	Pranuar	Në projekligjin “Për Kinematografinë dhe Audiovizualin”, neni 6 është ndryshuar dhe përqindjet hibride janë hequr. Neni mban nr.8 dhe është strukturuar si më poshtë vijon: “Burimet e Financimit të QKKA janë: a) fondet nga buxheti i shtetit, të parashikuara çdo vit si zë i veçantë buxhetor për Qendrën Kombëtare të Kinematografisë dhe Audiovizualit. b) fondet e përfituara nga programe dhe projekte kombëtare ose ndërkombëtare, në përputhje me kushtet e financimit; c) të ardhurat nga tarifat,

	Detyrimi për pagesën e 5% të tatim-fitimit nga subjektet që ofrojnë përmbajtje audiovizuale… ngre problematika serioze juridike. Propozim: Heqja e operatorëve audiovizivë nga lista e subjekteve kontribuese ose parashikimi i një mekanizmi kompensues… Për operatorët audiovizivë kjo krijon një regjim të dyfishtë regjistrimi. Aktualisht operatorët audiovizivë regjistrohen, autorizohen ose licencohen sipas legjislacionit sektorial dhe mbikëqyren nga AMA. Për këtë arsye duhet të përcaktohet qartë se regjistri i AKKA-së ka vetëm funksion statistikor dhe nuk përbën kusht për ushtrimin e aktivitetit audioviziv.			shërbimet dhe veprimtaritë e ligjshme të QKKA-së; ç) donacionet, sponsorizimet, të pranuara dhe të administruara në përputhje me legjislacionin në fuqi; d) të ardhura të tjera të ligjshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi..”

Neni 6 – Buxheti, pika 1, shkronja b(ii) – 5% të tatim-fitimit nga subjektet që ofrojnë shërbime të aksesit në internet dhe pika 1, shkronja b(iii) – 2% të tatim-fitimit nga operatorët e komunikimeve elektronike që ofrojnë shërbime telefonike dhe transmetimi të të dhënave.	Propozojmë rishikimin e Nenit 6 dhe përjashtimin e ofruesve të shërbimeve të internetit… ose financimi… vetëm në cilësinë e distributorit… të kufizohet: (i) në një përqindje jo më të madhe se 0.1% mbi të ardhurat bruto… ose (ii) një vlerë të sheshtë të arsyetuar… Neni 6 i projektligjit krijon me dashje një sistem të taksimit të dyfishtë kaskadë mbi një entitet të vetëm korporativ dhe krijon barrë të tepërt e të pajustifikuar për operatorët. Për më tepër, taksimi i ISP-ve dhe operatorëve të telekomunikacionit devijon nga kuadri i Direktivës së Shërbimeve të Medias Audiovizuale (AVMSD) të Bashkimit Evropian, e cila kufizon taksat kulturore në	TRING-5303 (ASC) KOELF ONE Albania ONE Albania	Pranuar	Në projektligjin “Për Kinematografinë dhe Audiovizualin”, neni 6 është ndryshuar dhe përqindjet hibride janë hequr.

	mënyrë strikte për ofruesit e shërbimeve mediatike me kontroll editorial. Si një operator i integruar që ofron paketa bundle (internet Fiks + abonim Celular + platformë IPTV/OTT), fitimi ynë neto i korporatës përpunohet ligjërisht si një regjistër i vetëm financiar i konsoliduar. Mbivendosja: Sipas parashikimeve të nenit 6, pika i-iii, për financimin e buxhetit të AKKA, për rastin e ONE Albania do të conte në taksimin 5% të platformave online IPTV/OTT (pika i), 5% si ofrues shërbimi interneti (pika ii), dhe 2% shtesë për shërbimet e transmetimit të të dhënave sipas nënpikës (iii).			
Rritja e buxhetit për krijimtarinë	Kërkojmë që të garantohet një rritje reale e fondit	APFA	Refuzuar	Sa do të jetë fondi i akorduar nga Buxheti i

(min. 2 mln €; +30%)	të dedikuar Industrisë Kinematografike, në mënyrë që ky fond të jetë të paktën 30% më i lartë se financimi aktual që shteti i akordon QKK-së. Një buxhet minimal prej 2 milionë eurosh për filmin autor shqiptar do t'i jepte kuptim reformimit. Fondet e dedikuara për Industrinë Kinematografike duhet të përcaktohen qartë dhe të mbrohen brenda buxhetit të përgjithshëm të AKKA-s.			Shtetit për QKKA-në, i nënshtrohet një procedure bazuar në legjislacionin në fuqi për menaxhimin e sistemit buxhetor, menaxhimin financiar dhe kontrollin, si dhe me ligjin vjetor të buxhetit.
Miraton kalendarin e thirrjeve publike, ndarjen e fondeve sipas gjinive kinematografike dhe audiovizuale.	Ligji duhet të parashikojë qartë se, përpara fillimit të çdo viti financiar, Këshilli Drejtues miraton kalendarin e thirrjeve publike, kategoritë e mbështetjes dhe ndarjen orientuese të fondeve sipas gjinive kinematografike dhe audiovizuale.	APFA	Pranuar	Lidhur me ndarjen së mbështetjes financiare, për kinematografinë dhe audiovizualin, në nenin 8, pika 2 të draftit përfundimtar është parashikuar se, nga fondi vjetor i miratuar për mbështetjen e projekteve, 70 përqind destinohet për projektet

				kinematografike dhe 30 përqind për projektet audiovizuale. Kjo ndarje zbatohet në përputhje me buxhetin e miratuar dhe rregullat për administrimin e fondeve publik.
Neni 8 - Përfaqësimi i audiovizualit në Këshillin Drejtues.	Projektligji parashikon vetëm një përfaqësues të industrisë audiovizive në Këshillin Drejtues prej pesë anëtarësh. Duke qenë se një pjesë e konsiderueshme e financimit të AKKA-së do të vijë pikërisht nga subjektet audiovizive, përfaqësimi i tyre me vetëm një anëtar nuk garanton balancë institucionale… Propozohet që numri i përfaqësuesve të sektorit audioviziv të jetë të paktën i barabartë me atë të sektorit kinematografik.	TRING-216	Pranuar	Qendra Kombëtare e Kinematografisë dhe Audiovizualit nuk do jetë e strukturuar në formën e një agjencie autonome, ku organizimi i brendshëm përbëhet nga Këshilli Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm, për rrjedhojë janë hequr nenet respektivë.

Neni 4 - Dobësim i Arkivit të Filmit dhe standardeve FIAF; heqja e përkufizimit "autor".	Projektligji i ri: dobëson dimensionin konservues dhe shkencor të Arkivit Qendror Shtetëror të Filmit; zhduk referencën eksplicite ndaj të drejtave morale dhe ekonomike të autorit; e orienton institucionin drejt logjikës spekulative të tregut; rrit rrezikun e komercializimit të trashëgimisë kulturore kombëtare; dhe largon Arkivin nga standardet ndërkombëtare të FIAF (International Federation of Film Archives). Nga Ligji aktual është hequr edhe përkufizimi ligjor i fjalës "autor" (Neni 4 Përkufizimet). Këto ndryshime lënë hapësira për legalizim të praktikave problematike ekzistuese, dobësim të mbrojtjes së autorëve, privatizim	LUMIERE	Refuzuar	Projektiligji nuk ndryshon funksionet e përcaktuara në aktet ligjore dhe nëligjore në fuqi për AQSHF-në. Ky projektligj, shton një formë bashkëpunimi në funksion të mbështetjes së sektorit të kinematografisë dhe audiovizualit. Për sa përket përkufizimit "autor", theksojmë se objekti dhe qëllimi i këtij projektligji si dhe kompetencat e QKKA-s, nuk rregullojnë të drejtat e autorit. Përkufizimet, i referohen termave të lidhura me kinematografinë dhe audiovizualin. Këtu përmendim përkufizimet e dy prej autorëve kresor, atë të regjisorit dhe të skenaristit.

	informal të restaurimeve dhe humbje graduale të kontrollit kulturor mbi trashëgiminë filmike shqiptare.			
Neni 6 - Pika 1 – 2% taksa e biletave	"Lidhur me Nenin 6 të Projektit (paragrafi 1) dhe propozimin për financimin e AKKA-së përmes një tarife prej 2% mbi çmimin e biletave të shitura në sallat e kinemasë, ne besojmë se kjo do të krijojë një barrë shtesë për sektorin e shfaqjes kinematografike, në një kohë kur ai po përpiqet gradualisht të rimëkëmbet."	MPA	Pranuar	Në nenin 6 të Projektligjit kjo pikë është hequr.
Koment i përgjithshëm – Rebate 35%	Me një industri të brishtë dhe treg të vogël, incentiva 35% rrezikon të funksionojë si subvencion disproporcional për prodhime të huaja, pa garanci për transferim dijeje apo forcim autorësie shqiptare. Kërkohet rishikim i thellë përmes konsultimi transparent; skema	LUMIERE	Refuzuar	Identiteti i kinemasë shqiptare nuk përcaktohet nga prezenca e prodhimeve të huaja në territor; sektori funksionon në bashkëpunim ndërkombëtar dhe nuk mund të mbahet vetëm nga buxheti i shtetit. Skema nuk financon

	mund të diskriminojë prodhimet vendase, të dobësojë identitetin e kinemasë shqiptare dhe të kthejë Shqipërinë në "call center kinematografik".			buxhetin e prodhimeve, por nxit rritjen e ekonomisë vendase përmes një nxitjeje financiare, pasi rimbursimi jepet vetëm për shpenzimet e kualifikuara të kryera në territorin e Republikës së Shqipërisë (neni 19, pika 1), duke përfshirë punësimin e profesionistëve shqiptarë. Skema nuk diskriminon prodhimet vendase, pasi përfituese janë prodhimet kombëtare ose ndërkombëtare (neni 19, pika 6). Rimbursimi kryhet brenda kufijve të fondit vjetor (neni 19, pika 3), ndërsa rregullat, kriteret dhe kufizimet e detajuara të skemës përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave (neni

				19, pika 7). Skema është instrument më vete nga mbështetja selektive për krijimtarinë vendase (neni 17, pika 2, shkronja a), e cila mbetet e pacenuar.
Koment i përgjithshëm	Shoqata e Kineastëve Shqiptarë Lumiere kërkon zbatimin e ligjit aktual të kinematografisë para çdo aventurimi në një ligj të ri ku prevalojnë rreziqet ndaj oportuniteteve.	LUMIERE	Refuzuar	Drafti i ri nuk cenon thelbin e ligjit aktual, i cili mbetet baza edhe e këtij drafti; përkundrazi, ai parashikon çështjet dhe ndryshimet e ardhura në sektor gjatë 30 viteve të fundit. Ligji nr. 8096/1996 nuk mbulon audiovizualin, platformat digjitale, nxitjet financiare për prodhimet dhe formatet seriale, të cilat kërkojnë përkufizime dhe rregullim bashkëkohor në përputhje me zhvillimet e sektorit dhe standardet

				evropiane. Prandaj kërkohet rregullim tërësor i ri.
Neni 8 (Në projektligjin e rishikuar, Këshilli Drejtues është hequr; neni 8 rregullon burimet e financimit të QKKA-së.)	Një prej shqetësimeve kryesore është humbja e pavarësisë institucionale e Qendrës Kombëtare të Kinematografisë. Projektligji ia heq QKK-së pavarësinë duke e shndërruar atë në një agjenci shtetërore (AKKA), në varësi të plotë të ekzekutivit, varësi direkte administrative e financiare të ministrisë përgjegjëse për kulturën. Sipas projektligjit, Ministria përgjegjëse për Kulturën dhe Ministria e Financave do të kenë nga një përfaqësues të tyre në Këshillin Drejtues të AKKA	LUMIERE	Pranuar pjesërisht	Në projektligjin e rishikuar, institucioni ruan statusin e Qendrës (QKKA) dhe Këshilli Drejtues, me përfaqësuesit e ministrisë përgjegjëse për kulturën dhe të Ministrisë së Financave, është hequr. QKKA-ja është person juridik publik, qendror, buxhetor, në varësi të Ministrit përgjegjës për kulturën (neni 6, pika 1). Statusi i varësisë nga Ministri mbetet i njëjtë me atë të QKK-së sipas ligjit në fuqi. Autonomia artistike dhe profesionale e vendimmarrjes garantohet nga Këshillat e

	(Neni 8 i projektligjit). Ndryshimi nga QKK në një agjenci plotësisht të varur nga ministria pritet të sjellë: centralizim politik, dobësim të autonomisë artistike, margjinalizim të filmit autoral, paqëndrueshmëri financiare, burokratizim, rritje klientelizmi dhe dobësim të besimit në sistem.			Miratimit të Projekteve, si organe kolegjiale të pavarura (neni 12, pika 2), anëtarët e të cilëve propozohen nga shoqatat profesionale, përzgjidhen me votim nga komuniteti profesional dhe emërohen nga Kryetari mbi bazën e rezultateve të procedurës (neni 12, pika 3). Kryetari nuk mund të ndryshojë përmbajtjen e vlerësimit artistik, renditjen e projekteve ose vendimmarrjen për përzgjedhjen e përfituesve (neni 11, pika 4). Ai mund ta kthejë vendimin e Këshillit për rishqyrtim vetëm një herë dhe vetëm për shkelje ligjore ose procedurale; pas rishqyrtimit, vendimi i

				Këshillit është përfundimtar (neni 12, pikat 10 deri 12).
Neni 6 -pika 1-f Tarifa 2% mbi biletat e kinemasë (Në projektligjin e rishikuar, neni 6, pika 1, shkronja f është rinumërtuar si neni 9, pika 1, shkronja ç.)	Financimi i AKKA-s përmes një tarife prej 2% mbi shitjen e biletave (neni 6, pika 1, shkronja f) vendos barrë shtesë financiare mbi operatorët e kinemave, të cilët tashmë i nënshtrohen tatimit 5% mbi fitimin. Kërkohet heqja e tarifës, ose ulja në maksimum 0.5% me përjashtime për filmat vendas dhe evropianë të pavarur, në përafrim me praktikën rajonale (Kroacia 0.5%, Kosova pa tarifë).	AmCham	Pranuar pjesërisht	Masa e kontributit mbi çmimin e biletave është ulur nga 2% në 1,5% (neni 9, pika 1, shkronja ç). Në terma monetarë absolutë, kontributi përfaqëson një shumë të papërfillshme dhe nuk krijon barrë të ndjeshme për operatorët. Kontributi prej 5% mbi sektorin audiovizual, i cili do të përbënte ngarkesë më të konsiderueshme, është hequr nga drafti. Kontributi mbetet burim i domosdoshëm dhe i qëndrueshëm për financimin e institucionit, ndërsa mënyra e

				llogaritjes, deklarimit, mbledhjes dhe kontrollit të tij përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave (neni 9, pika 5).
Neni 23 Afati i disbursimit dhe procedura (Në projektligjin e rishikuar, neni 23 është rinumërtuar si neni 19.)	Procedura e aplikimit dhe afatet e disbursimit të rimbursimit duhet të jenë të qarta, të shpejta dhe të parashikueshme, në përputhje me standardet ndërkombëtare, për të rritur besueshmërinë e skemës.	AmCham	Pranuar pjesërisht	Ligji përcakton parimet dhe kuadrin e përgjithshëm të skemës. Parashikueshmëria garantohet në ligj nëpërmjet shqyrtimit të kërkesave sipas datës dhe orës së regjistrimit të dokumentacionit të plotë dhe shpërndarjes së fondit sipas rendit kronologjik (neni 20, pikat 1 dhe 3). Sipas nenit 19, pika 7, procedurat, afatet, kriteret e pranueshmërisë, dokumentacioni dhe mekanizmat e kontrollit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Afatet dhe procedura e

				disbursimit janë çështje të natyrës zbatuese që rregullohen me akt nënligjor, çka garanton fleksibilitet dhe përditësim pa qenë nevoja për ndryshim të ligjit.
Neni 15 Sistemi i klasifikimit / Komisioni i Vizionimit (Në projektligjin e rishikuar, neni 15 është rinumërtuar si neni 26.)	Sistemi i detyrueshëm i lejes së qarkullimit dhe klasifikimit nga një Komision Vizionimi i përbërë vetëm nga përfaqësues të Ministrisë dhe AKKA-s shton një hallkë miratimi administrativ paraprak. Kërkohet zëvendësimi me një model bashkërregullues (vetëklasifikim dhe njoftim, model kroat), njohja e klasifikimeve të huaja evropiane, dhe përbërje e pavarur e organit me përfaqësues të industrisë, ekspertë dhe shoqëri civile.	AmCham /	Refuzuar	QKKA-ja është institucioni kryesor rregullator i sektorit kinematografik dhe audiovizual dhe duhet ta ruajë këtë rol. Klasifikimi sipas moshës dhe leja e qarkullimit (neni 26) shërbejnë për mbrojtjen e të miturve dhe ruajtjen e rendit publik, funksione që mbeten të domosdoshme dhe nuk mund të kalojnë tërësisht te vetëklasifikimi. Përbërja e Komisionit të Vizionimit ruhet siç parashikohet

				në nenin 26, pika 2. Njohja e klasifikimeve të lëshuara nga autoritete evropiane, për të shmangur riklasifikimin e panevojshëm, mund të trajtohet në rregulloren që përcakton kriteret e vlerësimit dhe procedurën për dhënien e lejes së qarkullimit (neni 26, pika 12).